REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2019:076496
Datë: 12.02.2020
Numri i dokumentit: 00827752

P.nr.58/2019

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA RAHOVEC/Departamenti i Përgjithshëm– Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Mizahir Shabani, me bashkëpunëtorin profesional Armond Qmega, në lëndën penale kundër të akuzuarit L. V. nga fshati Ç., Komuna e Rahovecit, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm, me numër PP/II.nr.124/2019, të datës 13.02.2019, në seancën publike të shqyrtimit fillestar të mbajtur, **me datë 10.02.2020** në prezencën e Prokurorit të shtetit Enis Gashi si dhe të akuzuarit, të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, këtë:

A K T GJ Y K I M

I akuzuari:

L. V., nga i ati S., e ëma A., e gjinisë Gj., data e lindjes ..., në Gjakovë, tani me vendbanim në fshatin Ç., Komuna e Rahovecit, i pa martuar, ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës, numër personal ....

ËSHTË FAJTOR

Sepse nga data e pa vërtetuar e gjerë me dt.20.09.2018, në shtëpinë e tij në fsh. Ç., K. Rahovec, me qëllim që vetës t'i sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm, në kundërshtim me dispozitën nenit 39 të Ligjit për energjinë elektrike të Republikës së Kosovës, ka shfrytëzuar rrymën elektrike në atë mënyrë që jashtë njehsorit elektrik me nr. 32592342, përmes një kabllo 4x16 mm, është lidhur direkt në rrjetin elektrik, me këtë veprim energjia elektrike e shpenzuar nuk është regjistruar, me ç'rast ndërmarrjes së dëmtuar i ka shkaktuar dëm material në shumë prej 189.60 €.

Me këto veprime ka kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të nenit 4, 6, 7, 17, 38, 39, 43, 69, 70, dhe 314 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, të akuzuarit e:

GJ Y K O N

2019:076497

ME DËNIM ME GJOBË në shumë prej 200 (dyqind) €uro, të cilin dënim i akuzuari duhet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjete) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi atëherë të akuzuarit dënimi me gjobë i zëvendësohet me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) ditëve, ashtu që për çdo ditë të kaluar në burgim do të llogaritet nga 20 (njëzet) €uro.

E dëmtuara K. – Distrikti në Gjakovë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Detyrohet **i akuzuari, që ti paguajë shpenzimet e paushallit gjyqësor shumën prej 30 (tridhjetë) €uro, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.**

A r s y e t i m

1. **Ecuria e procedurës penale**

Prokuroria Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm, pranë kësaj gjykate ka ngritur aktakuzën me numër PP/II.nr.124/2019, të datës 13.02.2019, kundër të akuzuarit L. V. nga fshati Ç., Komuna e Rahovecit, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 paragrafi 1 të KPRK-së. Prokurori i shtetit Enis Gashi, gjatë shqyrtimit fillestar ka qëndruar në tërësi pranë aktakuzës, njëherit bëri rikualifikimin e veprës penale, nga vepra penale "Vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së" në veprën penale "Vjedhja e shërbimeve nga nenin 314/6-1 të KPRK-së", i cili tani është në fuqi, duke marrë për bazë se ky ligj është më i favorshëm për të akuzuarin, pjesa tjetër mbetet e pandryshuar andaj, ka propozuar që i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

I akuzuari L. V., gjatë shqyrtimit fillestar ka deklaruar se: e pranon fajësinë për veprën penale sipas të gjitha pikave të aktakuzës, ndien veten fajtor për këtë vepër penale për të cilën ngarkohet dhe se ndien keqardhje për rastin që ka ndodhur.

Prokurori i shtetit Enis Gashi, duke dhënë mendim rreth pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit ka deklaruar se: nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, pasi që i njëjti pranimin e fajësisë e ka bërë me vullnet të lirë, pasi që i ka kuptuar favoret dhe pasojat e pranimit të fajësisë, po ashtu aktakuza gjen mbështetje në provat që gjenden në shkresat e lëndës.

2. Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të palëve ka marr aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë ngase ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë

2019:076497

tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 253 paragrafët 1 dhe 2 të KPP-së, për pushimin e procedurës penale përkatësisht hedhjen e aktakuzave.

3.Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike: - se i akuzuari L. V. me dashje ka kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

4. Elementet e veprës penale
Në nenin 314 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, është parashikuar se formën themelore të veprës penale vjedhja e shërbimeve e kryen: "Kushdo që me anë të lajthimit, largimit ose mënyrave tjera siguron shërbime për të cilat dihet se mundësohen vetëm në shkëmbim të kompensimit dhe shmang pagesën për shërbime të tilla, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet" po ashtu në paragrafin 6 parashihet se **"Për qëllime të këtij neni, vjedhja e shërbimeve të gazit, ujit, rrymës ose ngrohjes përfshin, por nuk kufizohet në marrjen, përdorimin, devijimin, nxjerrjen ose përfitimin nga ndonjë shërbim i gazit, ujit, rrymës ose ngrohjes që furnizohet nga ose përmes rrjetit përçues të rrymës apo rrjetit të shpërndarjes, pa autorizimin e furnizuesit të autorizuar."**

5. Vendimet e gjyqtarit të vetëm gjykues
Andaj, duke u bazuar në këto që janë cekur me lartë, gjyqtari i vetëm gjykues të akuzuarit L. V. e ka shpallur fajtor sipas aktakuzës së lartcekur, ngase në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së dhe për këtë ka vendosur që edhe ta gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuari: pranimin e fajësisë në shqyrtimin fillestar, ndërsa rrethana veçanërisht rënduese nuk gjeti. Kështu që duke mos gjetur rrethana tjera rënduese për të akuzuarin, gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimet e shqiptuara si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi, do të **arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit nga neni 38 dhe 43 i KPRK-së dhe këto dënime si i tilla të shqiptuara sipas bindjes së gjykatës janë në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimet e shqiptuara do të ndikojnë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.**

7. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarës që kërkesën pasurore-juridike ta realizojë në procedurë të rregullt juridiko civile bazohet në nenin 463 të KPPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 450 par.1 dhe 2 nënpar.2.6 lidhur me nenin 453 par.l të KPPK-së.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 365 të KPPK-së.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA NË RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal
P.nr.58/2019, me datë 10.02.2020

B. Profesional
Armond Qmega

Gjyqtari i vetëm gjykues
Mizahir Shabani

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.

2019:076497